

BUXHETI
BASHKIA E VAU DEJES

"Vau Dejes , me historinë, mikpritjen e burimet natyrore, një komunitet që jeton e zhvillohet, derë e hapur për integrim"

Përmbajtja

I.	Të dhëna demografike për Bashkinë e Vau Dejes	4
II.	Buxheti i Bashkisë për Vitet 2018-2020.....	6
III.	Ardhurat e Bashkisë për vitet 2018-2020	12
	III.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore	14
	III.2 Të ardhurat nga burimet qendrore	14
	III.1.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore	17
	A.1 Analiza e të ardhurave të veta vendore dhe ndikimet e tyre në të ardhurat e bashkisë	23
	A.1.1 Te ardhurat nga taksat vendore	24
	A.1.2 Te ardhurat nga Tarifat Vendore	30
	A.2 Parashikimi bazuar në politikat fiskale	36
	A.3 Trendi i rritjes së të ardhurave	37
	III.2.1 Transferta e Pakushtezuar	39
	III.2.2 Transferta specifike sipas funksioneve.	41
	III.2.3 Transferta e kushtezuar.	44
V.	Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2018-2020.....	45
	Aneks 1: Baza ligjore	50

Detajimi i Programevebuxhetore

- P1.Planifikim Manaxhim Administrim
- P2.Planifikimi urban
- P3.Infrastruktura rrugore
- P4.Sherbimet Publike
- P5. Mjedi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave
- P6. Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi
- P7.Bujqesia dhe zhvillimi rural
- P8. Mbrojtja nga zjarri dhe shpetimi
- P9.Arsimi parauniversitar dhe edukimi
- P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale

LISTA E TABELAVE

TABELA 1 NDARJA NË LAGJE DHE FSHATRA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SË VAU DEJES	5
TABELA 2 PLANIFIKIMI PËR VITIN 2018- 2020 SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE	
TABELA 3 PLANIFIKIMI I BUXHETIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK	9
TABELA 4 PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE SIPAS FUNKSIONEVE PËR VITIN 2018-2020	9

TABELA 5 TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA TË BASHKISË PËR VITIN 2018-2020	14
TABELA 6 TË ARDHURAT NGA BURIMET QENDRORE PER VITIN 2018-2020.....	15
TABELA 7 TRANSFERTA SPECIFIKE PËRKATËSISHT SIPAS FUNSIONEVE TË TRANSFERUARA	16
TABELA 19 PLANI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2018 SIPAS PROGRAMEVE	47
TABELA 20 REALIZIMI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2019 SIPAS PROGRAMEVE..	47
TABELA 21REALIZIMI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2020 SIPAS PROGRAMEVE ...	48

LISTA E FIGURAVE

FIGURE 1 HARTA TREGUESE BASHKIA VAU DEJES	4
---	---

LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU 3 PLANI BUXHETOR SIPAS PROGRAMEVE DHE VITEVE.....	8
GRAFIKU 4 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK VITI 2018-2020	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
GRAFIKU 6 TË ARDHURAT E BUXHETIT 2018-2020	14
GRAFIKU 7 TË ARDHURAT NGA BURIMET QENDRORE PËR VITIN 2018-2020.....	15
GRAFIKU 8 SHPERNDARJA E TRANSFERTES SPECIFIKE SIPAS PROGRAMEVE 2018-2020.....	17

I. Të dhëna demografike për Bashkinë e Vau Dejes

Bashkia e Vau-Dejës bën pjesë në Qarkun e Shkodrës, me distance 20 km nga Shkodra, 92 km nga Tirana dhe 81 km nga Aeroporti i Rinasit. Ajo ka një sipërfaqe prej 468 km² ku 10 465 ha janë tokë bujqesore. Bashkia e Vau-Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë-Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë.




Figure 1 Harta treguese Bashkia Vau Dejes

Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Vau Dejës, Bushat, Vig-Mnele, Hajmel, Temal, Shllak. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Shkodrës dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra.

Ajo përbëhet nga 6 njësi administrative me një popullsi prej 50 130 banorë, përkatësisht: Vau-Dejës me 13 035 banorë, Bushat me 24 200 banorë, Vig-Mnelë me 2 177 banorë, Hajmel me 6 300 banorë, Temal me 2 520 banorë dhe Shllak me 1 899 banorë.

Aktiviteti kryesor ekonomik është bazuar në bujqësi dhe blegtori, biznesi i vogël dhe shërbimet.

Vau-Dejes gjithashtu ka një zhvillim në sektorin e prodhimit të energjisë, me hidrocentralin e Vaut të Dejës, të Komanit, me HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2.

Në bashkinë e Vau të Dejës ndodhet dhe Landfilli rajonal I Bushatit, si pike grumbulimi dhe përpunimi i mbetjeve për rajonin Vau Dejes -Lezhë.

Tabela 1 Ndarja në Lagje dhe fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë së Vau Dejes

Bashkia Vau –Dejës

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM ²
Shkodër	Qyteti Vau-Dejës	Vau-Dejës	Qytetet Vau Dejes, Fshatrat; Mjede, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe	30,438	50,042	468,00
		Bushat	Fshatrat; Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten			
		Vig-Mnele	Fshatrat; Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig			
		Hajmel	Fshatrat; Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë			
		Temal	Fshatrat; Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Kllogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë			
		Shllak	Fshatrat; Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj			

II. Buxheti i Bashkisë për Vitet 2018-2020.

Hartimi i buxhetit per vitet 2018-2020 është bere bazuar në ligjin Nr.139/2015, ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ,Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, udhezimit të Ministrise se Financave Nr.2, date 06.02.2012 “Per proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhezimin nr. 23 date 22.11.2016 “ *Per procedurat standarte te pergatitjes se programit Buxhetor Afatmesem*”. Sipas kerkesave të percaktuara në udhezimit Plotesues 10/1 date 28.2.2017 “ “ Per pergatitjen e buxhetit vendor, Kryetari i Bashkise ka miratuar kalendarin e hartimit të Programit Buxhetor Afat-Mesem (PBA), duke percaktuar veprimtarine e punes të Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP), si me poshte vijon:

- Propozimin e strukturës së programeve duke siguruar perfshirjen brenda një programi shpenzimesh të funksioneve kryesore të njësisë.
- Shpërndarjen tek çdo Ekip i Menaxhimit të Programit të udhëzimeve të brendshëm të nënshkruara nga titullari në lidhje me zbatimin e proçedurave të programit buxhetor afatmesëm.
- Diskutimin me drejtuesit e programeve për dokumentin e risqeve të paraqitur prej tyre dhe përcaktimin e risqeve prioritare për t’u diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
- Nënshkrimin e të gjithë raporteve të përgatitjes së kerkesave buxhetore për përdorim të brendshëm të njesise në lidhje me Rishikimin e Politikës së Programit dhe Planifikimin e Shpenzimeve të Programit.
- Prezantimin tek Kryetari i Grupit të Menaxhimit Strategjik të të gjithë dokumentacionit të kerkesave buxhetore.

Ne baze të urdherit të Kryetarit jane miratuar programet dhe funksionet të cilat do të perfshihen në Programin Buxhetor afat-mesem 2018-2020.

Llogaritja e nivelit të transfertes se pakushtezuar është bere në baze me 2 % rritje ne vitin 2018 ,me 5.4 % rritje ne 2019 dhe 10.3% rritje ne 2020

Nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve të ngritura në baze të vendimeve tëGMS fillimisht u be vleresimi i programevelidhur me planifikimin e buxhetor per periudhen 2018-2020, mbi bazen e:

- Analizes se tendencës se të ardhurave (te ardhurat gjithsej një vit me pare, viti aktual dhe per tre vitet e ardhshme).
- Analizes se politikave dhe objektivave të programeve sipas funksioneve të veta, të deleguara dhe atyre specifike duke marre në konsiderate të dhenat financiare të një viti me pare, vitit aktual dhe parashikimin dhe planifikimin per tre vitet e ardhshme.
- Analizes se shpenzimeve operative (një vit me pare, viti aktual dhe per tre vitet e ardhshme).

- Analizes se parashikimit të shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2018-2020 sipas çdo programi dhe funksioni (per tre vitet e ardhshme).
- Prioriteteve të konsultuara të investimeve në fushën e infrastruktures publike.
- Analizës se vlerësimit të projekteve dhe lidhjen e tyre me programet e shpenzimeve publike.
- Analizes se shërbimeve të mirembajtjes së objekteve arsimore, administrative, rrugëve të brendshme dhe atyre rurale.
- Analizes se shpenzimeve të funksioneve specifike të deleguara në vitin 2017.

Një qeverisje vendore, e ndjeshme nga ana gjinore, merr parasysh nevojat, interesat, përparësitë dhe shqetësimet e ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, si qytetarë.

Ajo shfrytëzon këto nevoja të ndryshme për t'i integruar në të gjitha proceset e qeverisjes vendore, të tilla si hartimi i politikave, planifikimi, shpërndarja e buxhetit, zhvillimi i programit, dhënia e shërbimeve sociale dhe monitorimi i rendimentit - në mënyrë që të trajtojë drejtpërdrejtë pabarazitë gjinore ekzistuese

Për t'ju përgjigjur më së miri nevojave dhe problematikave, të të gjitha kategorive, përmirësimit të cilësisë së jetës për banorët e bashkisë së Vau Dejes , meshkujve dhe femrave, vajzave dhe djemve, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 "Përbarazinëgjinorenëshoqëri", Strategjisë kombëtare për barazinëgjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunë në familje, etj. është kushtuar vëmendje buxhetimit gjinor dhe shërbimeve sociale.

Në hartimin e projekt buxhetit për vitet 2018 – 2020, Bashkia e Vau Dejes , në zbatim të ligjit për barazinë gjinore dhe udhëzimeve përkatëse, është mbështetur dhe ka kushtuar vëmendje buxhetimit të ndjeshëm gjinor.



Buxhetit i Bashkisë së Vau Dejes për vitin 2018 është planifikuar 774,166 mijë lekë, ndër të cilat 154 565 mijë lekë (20%) nga të ardhurat e veta, 201,808 mijë lekë (26%) transfertë e pakushtëzuar, 101,338 mijë lekë (13%) transfertë specifike, dhe 316,455 mijë lekë (41 %) transfertë e kushtëzuar.

Buxhetit i Bashkisë së Vau Dejes për vitin 2019 është planifikuar 800,002 mijë lekë, ndër të cilat 163 175 mijë lekë (20%) nga të ardhurat e veta, 212,705 mijë lekë (27%) transfertë e pakushtëzuar ,101,338 mijë lekë (13 %) transfertë specifike, dhe 322,784 mijë lekë (40 %) transfertë e kushtëzuar .

Buxhetit i Bashkisë së Vau Dejes për vitin 2020 është planifikuar 839,214 mijë lekë, ndër të cilat 174 115 mijë lekë (21%) nga të ardhurat e veta, 234,614 mijë lekë (28%) transfertë e

pakushtëzuar, 108,533 mijë lekë (13%) transfertë specifike, dhe 321,952 mijë lekë (38 %) transfertë e kushtëzuar.

Disa tregues të rëndësishëm për buxhetin



Grafiku 1 Plani buxhetor sipas programeve dhe viteve

Tabela 2 Planifikimi i buxhetit sipas klasifikimit ekonomik

000/leke

Programe	Paga +	Shpenzime		Investime	Totali
	Sigurime	Operative	Transferta		
Viti 2018	222,269	146,443	316,455	89,000	774,167
Viti 2019	239,802	146,865	322,784	90,552	800,003
Viti 2020	265,566	150,773	321,952	100,923	839,214





Tabela 3 Planifikimi i shpenzimeve sipas funksioneve për vitin 2018-2020

P/Plani Viti 2018

Programe	Ne perqindje
Planifikim Manaxhim	
Administrim	7.8%
Planifikimi urban	1.9%
Infrastruktura rrugore	40.1%
Programi i Sherbimeve Publike	2.8%
Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.	4.5%

Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	4.9%
Bujqesia dhe zhvillimi rural	2.8%
Mbrojtja nga zjarri dhe shpetimi	0.5%
Arsimi dhe kultura	17.0%
Shërbimet sociale	17.4%
Fond rezerve	0.2%




P/Plani Viti 2019

Programe	Ne perqindje
Planifikim Manaxhim	
Administrim	8.1%
Planifikimi urban	1.2%
Infrastruktura rrugore	38.0%
Programi i Sherbimeve Publike	3.1%
Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.	3.3%
Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	4.9%
Bujqesia dhe zhvillimi rural	2.2%
Mbrojtja nga zjarri dhe shpetimi	0.5%
Arsimi dhe kultura	13.9%
Shërbimet sociale	24.7%


Fond rezerve

0.2%



P/Plani Viti 2020

Programe	Ne perqindje
Planifikim Manaxhim	
Administrim	9.0%
Planifikimi urban	0.9%
Infrastruktura rrugore	19.5%
Programi i Sherbimeve Publike	3.4%
Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.	4.0%
Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	3.9%
Bujqesia dhe zhvillimi rural	2.3%
Mbrojtja nga zjarri dhe shpetimi	0.6%
Arsimi, sporti, kultura	31.5%
Shërbimet sociale	24.7%
Fond rezerve	0.2%



III. Ardhurat e Bashkisë për vitet 2018-2020

Sipas nenit 34 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësitë vendore u garantohej me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

Të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Vau Dejes , nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë: për vitin 2018, në shumën 774,167 mijë lekë, për vitin 2019 në shumën 800,003 mijë lekë dhe për vitin 2020 në shumën 839,214 mijë lekë.

Këto të ardhura, sipas ligjit të mësipërm, vijnë nga dy burime të ardhurash si më poshtë:

A. Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat tatimore (nga taksat vendore), jo tatimore (nga tarifat për shërbimet publike që ofrojnë dhe të ardhurat e tjera vendore), donacione.



B. Nga burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja që i janë transferuar Bashkisë dhe transferta e kushtëzuar.


Bashkia Vau Dejes për vitet 2018 - 2020, duke përfshirë, transfertën e pa kushtëzuar, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhura të tjera parashikon për vitin 2018 rreth 356,373 mijë lekë të ardhura të veta, për vitin 2019 rreth 375,880 mijë leke dhe në vitin 2020 rreth 408,729 mijë leke.

Tabela e mëposhtme paraqet të ardhurat e veta të Bashkisë Vau Dejes për vitet 2018-2020 sipas çdo burimi.

**Të ardhurat e veta të Bashkisë për vitin 2018-2020
(000/lekë)**

Nr.	Të ardhurat e veta	Plan 2018	Plan 2019	Plan 2020
I	Nga burimet e veta vendore	154 565	163 175	174 115
1	Të ardhurat tatimore/taksat	63 765	66 000	69 295
2	Të ardhurat nga tarifat	60 100	62 570	66 500
	Te ardhura te tjera	30 700	34 605	38 230
II	Nga burimet qendrore			
1	Transferta e pakushtëzuar	201,808	212,705	234,614
	TOTALI	356,373	375,880	408,729





Grafiku 2 Të ardhurat e buxhetit 2018-2020

III.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore

Tabela e mëposhtme paraqet parashikimin e të ardhurave të veta për Bashkisë Vau Dejes për vitin 2018-2020 sipas çdo burimi.

Tabela 4 Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë për vitin 2018-2020

	000/leke		
TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
TË ARDHURA TATIMORE/NGA TAKSAT VENDORE	63,765	66,000	69,295
TË ARDHURA NGA TARIFAT	60,100	62,570	66,500
TË ARDHURA TË TJERA	30,700	34,605	38,320
Totali	154,565	163,175	174,115

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave me parashikim prej 154 565 mijë lekë për vitin 2018, 163 175 mijë lekë për vitin 2019 dhe 174 115 mijë lekë për vitin 2020, dhe zënë mesatarisht 8 % të totalit të të ardhurave gjithsej nga të gjitha burimet të Bashkisë Vau Dejes të parashikuara.

Krahasuar me të ardhurat e veta, ku përfshihet edhe transferta e pakushtëzuar zë mesatarisht 42.6 % të totalit të të ardhurave të veta së bashku me transferen e pakushtëzuar


III.2 Të ardhurat nga burimet qendrore

Të ardhurat nga burimet qendrore përfshijnë të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, transferta e kushtëzuar.

Burimet e Financimit	000/leke		
	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR	201808	212,705	234,614
TRANSFERTA SPECIFIKE	101,338	101,338	108,533
TRANSFERTA E KUSHTEZUAR	316,455	322,784	321,784
Totali	619,601	636,827	664,931

Tabela 5 Të ardhurat nga burimet qendrore per vitin 2018-2020

Të ardhurat nga burimet qendrore per vitin 2018 janë 619,601 mijë lekë ,për vitin 2019 jane parashikuar 636,827 mijë lekë dhe për vitin 2020 jane parashikuar 664,931 mijë lekë dhe përfshijnë transfertën e pakushtëzuar dhe atë specifike për funksionet e reja si dhe transfertën e kushtëzuar.





Grafiku 3 Të ardhurat nga burimet qendrore për vitin 2018-2020

Për vitet 2018-2020 krahas transfertës së pakushtëzuar akordohet edhe fondi i transfertës specifike për funksionet e reja prej 101,338 mijë lekë për 2018, 101,338 mijë lekë për 2019 dhe 108,5338 mijë lekë për 2020.

Tabela 6 Transferta specifike përkatësisht sipas funksioneve të transferuara

TRANSFERTA SPECIFIKE	000/leke		
	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Arsimi parauniversitar	10,927	10,927	11,703
Arsimi parashkollor	36,329	36,329	38,908
Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	12,393	12,393	13,273
Administrimi i pyjeve	5,394	5,394	5,777
Rrugët rurale	5,605	5,605	6,003
Ujitja dhe Kullimi	11,690	11,690	12,520
TOTALI	101,338	101,338	108,533





Grafiku 4 Shperndarja e transfertes specifike sipas programeve 2018-2020

III.1.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës së kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal. Pra, pjesë përbërëse e këtyre të ardhurave janë dhe ato që trashëgohen nga viti i mëparshëm.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Vau Dejes , e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agentët tatimorë.

	000/leke		
TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
TË ARDHURA TATIMORE/NGA TAKSAT VENDORE	63,765	66,000	69,295
TË ARDHURA NGA TARIFAT	60,100	62,570	66,500
TË ARDHURA TË TJERA	30,700	34,605	38,320
Totali	154,565	163,175	174,115

Te ardhura nga burimet e veta





Tabela e mëposhtme pasqyron planin e të ardhurave të veta për vitet 2018-2020 të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor:

000/leke

	LLOJET E TË ARDHURAVE	Plani 2018	Plani 2019	Plani 2020
A	TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA GJITHSEJ	154,565	163,175	174,115
A.I	TË ARDHURA TATIMORE/NGA TAKSAT VENDORE	63,765	66,000	69,295
I.1	Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	510	525	540
I.1.0	Taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	30	20	10
I.2	Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e			

	paluajtshme	45,835	47,085	49,535
<i>1.2.1</i>	<i>Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat</i>	<i>28,500</i>	<i>29,550</i>	<i>31,800</i>
<i>1.2.1.1</i>	<i>Ndërtesa banimi</i>	<i>6,000</i>	<i>6,500</i>	<i>6,700</i>
<i>1.2.1.2</i>	<i>Ndërtesa të tjera</i>	<i>22,000</i>	<i>22,500</i>	<i>24,500</i>
<i>1.2.1.3</i>	<i>Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike.</i>	<i>500</i>	<i>550</i>	<i>600</i>
<i>1.2.4</i>	<i>Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore</i>	<i>15,135</i>	<i>15,135</i>	<i>15,135</i>
<i>1.2.5</i>	<i>Të ardhura nga taksa mbi truallin</i>	<i>2,200</i>	<i>2,400</i>	<i>2,600</i>
1.3.	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	120	150	150
1.4	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6,000	6,500	7,000
1.5	Të ardhura nga garanci financiare	0	0	0
1.6	Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	520	550	570
1.7	Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	8,000	8,200	8,400
1.8	Të ardhura nga taksa e rentës minerare	50	70	90
1.9	Të ardhura nga taksa e tabelës	2,700	2,900	3,000
A.II	Të ARDHURAT JOTATIMORE	90,800	97,175	104,820

II	Të ardhurat nga Tarifat vendore	60,100	62,570	66,500
II.1	Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	28,000	26,700	27,500
<i>II.1.1</i>	<i>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga familjet</i>	<i>9,000</i>	<i>9,200</i>	<i>9,500</i>
<i>II.1.2</i>	<i>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga institucione</i>	<i>4,000</i>	<i>4,500</i>	<i>5,000</i>
<i>II.1.3</i>	<i>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga biznesi</i>	<i>15,000</i>	<i>13,000</i>	<i>13,000</i>
II.2	Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	5,900	6,250	6,700
<i>II.2.1</i>	<i>Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga familje</i>	<i>3,000</i>	<i>3,200</i>	<i>3,500</i>
<i>II.2.2</i>	<i>Te ardhura nga tarifë ndricimi nga institucione institucione</i>	<i>500</i>	<i>550</i>	<i>600</i>
<i>II.2.3</i>	<i>Të ardhura nga tarifë ndricimi nga biznesi</i>	<i>2,400</i>	<i>2,500</i>	<i>2,600</i>
II.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	2,900	3,320	3,850
<i>II.3.1</i>	<i>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga familjet</i>	<i>1,000</i>	<i>1,200</i>	<i>1,500</i>
<i>II.3.2</i>	<i>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga institucionet</i>	<i>100</i>	<i>120</i>	<i>150</i>
<i>II.3.3</i>	<i>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga biznesi</i>	<i>1,800</i>	<i>2,000</i>	<i>2,200</i>
II.4	Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	23,300	26,300	28,450
<i>II.4.1</i>	<i>Nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit</i>	<i>100</i>	<i>200</i>	<i>250</i>

II.4.2	<i>Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të therura</i>	800	1,000	1,100
II.4.3	<i>Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit</i>	500	700	800
II.4.4	<i>Nga tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike</i>	500	700	900
II.4.5	<i>Nga tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj</i>	2,000	2,200	2,800
II.4.6	<i>Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.</i>	18,000	19,500	20,000
II.4.7	<i>Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ</i>	200	250	300
II.4.8	<i>Nga tarifa për zënien e hapësirave publike</i>	500	700	1,000
II.4.9	<i>Nga tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille</i>	200	400	600
II.4.10	<i>Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)</i>	500	650	700
III	TË ARDHURA TË TJERA	30,700	34,605	38,320
III.1	Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	1,800	2,000	2,100
III.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë	21,000	23,500	25,000
III.3	Të ardhura nga sekuestime dhe zhdëmtime	100	120	150
III.4	Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve	150	170	200
III.5	Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	100	150	200

III.6	Të ardhura nga privatizimi	50	65	70
III.7	Të ardhura te tjera	500	600	600
III.8	Të ardhura nga sponsorizimet	7,000	8,000	10,000

Të ardhurat përfshijnë burimet nga taksat, nga tarifrat, si dhe nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat me rreth 41 %

Plani e të ardhurave të veta të Bashkisë së Vau Dejes për vitet 2018-2020

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Vau Dejës është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacion i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në vite si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to.


Si rrjedhim i reformës territoriale dhe të ardhurave të trashëguara nga njësitë vendore të shkrira si dhe ndryshimeve ligjore për taksat vendore, të ardhurat e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2016, 2017 paraqiten me një rritje të ndjeshme në krahasim me periudhat e mëparshme ndërsa për vitet 2018 e 2020 mendohet të kenë rritje përkatësisht me 15% më shumë se viti respektiv i mëparshëm.

Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat, që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për kete periudhe afatmesme reflekton dhe ndryshimet në paketën fiskale si dhe parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifrat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve;

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë:

- Rritja të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse &tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve;



Peshën specifike kryesore në të ardhurat totale të veta e mbulojnë kryesisht të ardhurat nga taksa e taksa e ndertesës me rreth 29.7% , tarifatat për pastrimin që zë rreth 18.1%, tarifa e shërbimit të administratës me 15.1% ,henia e aseteve në pronësi të bashkisë me qira etj.

A.1 Analiza e të ardhurave të veta vendore dhe ndikimet e tyre në të ardhurat e bashkisë

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifatat për shërbimet publike dhe të ardhurat e tjera vendore.


Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve të sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.



Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ;
3. Vendimet e Këshillit të Bashkisë Vau Dejes ”Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejes “;

A.1.1 Te ardhurat nga taksat vendore

TË ARDHURA TATIMORE/NGA TAKSAT VENDORE	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	510	525	540
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	30	20	10
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	28,500	29,550	31,800
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	15,135	15,135	15,135
Të ardhura nga taksa mbi truallin	2,200	2,400	2,600
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	120	150	150
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6,000	6,500	7,000
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	520	550	570
Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	8,000	8,200	8,400
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	50	70	90
Të ardhura nga taksa e tabelës	2,700	2,900	3,000
TOTALI	63,765	66,000	69,295





a) Taksa mbi Pasurinë.

Në kete parashikim perfshihen te ardhurat nga kategoria familjare dhe kategoria e biznesit, si me poshte:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
- Ndertesa banimi	6,000	6,500	6,700
- Ndertesa te tjera	22,000	22,500	24,500
- Ndertesa ne pronesi apo ne perdorim ne terriore te miratuara si	500	550	600

Shifrat e mësipërme tregojnë se për vitin 2018 do të kemi një rritje për rreth 2,7 milion leke nga kategoria familjare dhe biznesit si dhe rritje për dy vitet që vijojnë.

b) Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

Si rezultat i reformës administrative – territoriale, Bashkise Vau Dejes janë shtuar edhe sipërfaqe toke bujqësore por jo vetëm që shtrihen në hapsirat e njësive administrative (ish komunave)

Parashikimi i të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore për vitet 2018-2020, është si më poshtë:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Taksa mbi tokën Bujqësore	15,135	15,135	15,135

c) Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në m², në pronësi apo përdorim të

taksapagues

.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.


Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në tabelën e mëposhtme.

Për vitet 2018 - 2020 parashikimi i të ardhurave është si më poshtë:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Taksa mbi truallin	2,200	2,400	2,600

d) Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël.

Çdo biznes, i cili realizon gjatë vitit një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.



Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, bazuar ne realizimin faktit te vitit 2016 dhe ne pritshmerine e vitit 2017, për vitet 2018-2020 ka parashikuar te kemi nje rritje te tyre, si

më poshtë:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Tatimi Thieshtuar mbi Fitimin e BV	510	525	540

e) Taksa për fjetjen në hotel.

Taksa e fjetjes në hotel, bazohet në aktivitetin si motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër me këtë destinacion.

Per vitet 2018 - 2020 eshte parashikuar rivendosja e nivelit te takses ne 35 leke dhe 105 leke sipas percaktimeve ne ligj, kjo dhe per faktin se ulja e nivelit te takses jo vetem qe solli ulje te te ardhurave por dhe abuzime nga subjektet duke mos

raportuar situaten reale te aktivitetit, kjo dhe per mungese e kontrollit sistematik nga strukturat pergjegjese.

Parashikimi i te ardhurave nga taksa e fjetjes ne hotel per vitet 2018-2020, eshte si me poshte:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Taksa e fjetjes në hotel	120	150	150

f) Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Taksas se ndikimit në infrastrukturë nga lejet e ndërtimit i nenshtrohen te gjitha subjektet qe kerkojne te pajisen me leje zhvillimore per ndertim objekte banimi, administrative, prodhimi, sherbimi e tjera.

Referuar nivelit të takses pritshmërisë së lejeve për shqyrtim e miratim (pershire edhe ato te depozituara prej kohesh prane Bashkise Vau Dejes), per vitet 2018-2020, parashikimi nga kjo takse, paraqitet:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	6,000	6,500	7,000

g) Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Për vitin 2018, Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është parashikuar në masën 520 lekë, me nje mundesi realizimi per shkak te lehtesimit te procedurave nga Bashkia Vau Dejes ne bashkepunim me ZRPP dhe gjendjes se nje numri te madh objektesh ende te pa tjetersuar per shkak te pengesave nder vite per pajisje me leje perdorimi.

Realizimi i kësaj takse kryesisht nga strukturat e ZVRPP, agjent tatimor qe perfiton edhe

3% te shumes se arketuar.

Bazuar ne keto nivele te takses jane kryer dhe kalkukimet per parashikimin e saj per vitet 2018-2020 , si me poshte:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
--	-----------	-----------	-----------

Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e	520	550	570
---	-----	-----	-----

h) Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

E ardhura nga taksa, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Tirane) para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.

Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 18 % e të ardhurave vjetore mbasi është zbritur vlera e 5% që i takon agjentit tatimor DPSHTRR.

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Taksa vjetore e mjeteve të	8,000	8,200	8,400

i) Taksa e tabelës.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve, subjekteve të transportit dhe profesionet e lira.

Taksa e tabelës përbëhet :

- Tabelë për qëllime identifikimi
- Tabele për qëllime reklamimi

Taksa e tabelës për qëllime identifikuese ndahet në:

- Tabelë për qëllime identifikimi:
- Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme:
- Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

Mbështetur në realizimin e viteve të mëparshme por dhe në ecurinë e arkëtimit të kësaj takse, janë kryer edhe evidentimet mbi subjektet e kësaj takse.

Konkretisht, kundrejt të pritshmit të të ardhurave për vitin 2017, numrit të subjekteve të

evidentuara dhe nivelit te takses se miratuar sipas ligjit, parashikimi i te ardhurave per 2018-2020, paraqitet në tabelën si më poshtë:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Taksa e tabelës	2,700	2,900	3,000

j) Tarifa për zënien e hapësirave publike.

Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në m2 të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit e indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të takses për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak e cila përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj
- Zënia e hapësirës publike në tregjet publike.
- Zënia e hapësirës publike për organizimin e spektakleve ose panairëve të




ndryshme

Mbi këto baze janë parashikuar edhe të ardhurat e kësaj tarife për vitet 2018-2020, është si më poshtë:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Tarifa për zënien e hapësirave publike	500	700	1,000

A.1.2 Te ardhurat nga Tarifat Vendore

Të ardhurat nga Tarifat vendore	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
<i>tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave</i>	28,000	26,700	27,500
<i>tarifa për ndriçimin public</i>	5,900	6,250	6,700
<i>tarifa për gjelbrimin</i>	2,900	3,320	3,850
<i>tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë</i>	23,300	26,300	28,450
TOTALI	60,100	62,570	66,500



Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënieve të licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj;

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Për periudhën 2018-2020 parashikohet që tarifimi të ngarkohet kryesisht taksapaguesve duke u bazuar, në vendodhjen e tyre, në llojin e aktivitetit, në statusin e biznesit ose familjes, në numrin e anëtarve të familjes, në statusin e familjes, etj. Me konkretisht parashikohet që tarifimi të ngarkohet kryesisht taksapaguesve duke u bazuar:

në vendodhjen e tyre: zonë urbane qendër, zonë urbane periferike, zonë rurale në zhvillim, zonë rurale periferike, zonë turistike etj,

në llojin e aktivitetit: tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, aktivitet transporti, ndërtimi, karburanti, institucion, ofj, etj, ku do të bëhen edhe nënkategorizime të veçanta referuar llojit të aktivitetit të biznesit kryesisht për tarifën e pastrimit bazuar në shërbimin që ato marrin,

në statusin e biznesit ose familjes: biznes i madh, biznes i vogël, ambulant, fermer etj. si dhe sipas numrit të anëtarve të familjes, të statusit të familjeve me vështirësi sociale etj.

Në tarifën vendore përfshihen:

Tarifa e pastimit dhe largimit të mbeturiave

Tarifa për zënien e hapësirave publike

Tarifa e ndriçimit publik

Tarifa për gjelbërimin

Tarifën për shërbimet administrative, që përfshijnë tarifën nga

Shërbimi i kontrollit të zhvillimit të territorit

Shërbimi i vulojsjes veterinarë

Liçensimi i mjeteve të transportit

Parkimi i mjeteve të liçensuara dhe parkimi i rezervuar

Liçensimi për tregtimin e naftës dhe nënprodukteve

Shërbimi në institucione të arsimit, kulturës, sportit etj.

Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në m2 të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit e indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të taksës për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak e cila përbëhet nga:

- Zënia e hapsirës publike me kangjella, platforma, vazo etj
- Zënia e hapsirës publike në tregjet publike.
- Zënia e hapsirës publike për organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme

Mbi këto baze janë parashikuar edhe të ardhurat e kësaj tarife për vitet 2018-2020, është si më poshtë:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Tarifa për zënien e hapësirave publike	500	700	1,000

I) Tarifa e Pastrimit dhe largimit të mbeturinave.

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Vau Dejës.

Referuar realizimit të kësaj tarife ndër vite dhe kapacitetit të taksapaguesve, edhe gjykuar të të kemi një rritje të të ardhurave për këto tarife. Gjithashtu, duke filluar nga viti 2018, bazuar në nivelin e shërbimit të premtuar, për pasoj edhe të shpenzimeve për të, për vitet

2018-2020 do të kemi parashikimet, si më poshtë:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Tarifa e pastrimit	28,000	26,700	27,500
- Familjarët	9,000	9,200	9,500
- Subjektet Tregtare	15,000	13,000	13,000
- Institucione	4,000	4,500	5,000

Parashikimi te ardhurave nga subjektet e biznesit eshte mbeshtetur ne kapacitet e taksapaguesve per perfaqesone numrin e subjekteve te evidentuara aktiv dhe nivelit te tarifave epr vitin ushtrimor, te ardhura qe trajtohen nga strukturat e Drejtorise se Pergjithshme te Taksave dhe Tarifave Vendore,

m) Tarifa e Vendparkimit.

Tarifa për parkimin e automjeteve në vend parkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia Vau Dejes për vendqëndrime të mjeteve kundrejt biletës, atyre të rezervuara dhe për taksitë e liçensuara si dhe te klasifikuara si me poshte:

Krahas kesaj tarife ne vendparkime te vecanta ne rruge, do aplikohen edhe nivele tarife te ndryshueshme per sheshe te miratuara dhe vendparkime me rezervim kryesisht ne rruge, ne sherbim te subjekteve biznesi dhe institucioneve shteterore.

o) Tarifa per dhenie licence per tregtim karburati e lende Djegese.

Tarifa per dhenien e licencave te tregtimit te karburantit dhe lendeve djegese eshte detyrim per te gjitha pikat e tregtimit fundor ne territorin e Bashkise Vau Dejes


Qellimi i miratimit te kesaj tarife eshte rregullimi i tregut te karburanteve dhe lendeve djegese, per nje shperndarje racionale dhe nje miradministrim te territorit duke shmangur ngritjen e pikave te tregtimit te tyre ne afersi te ndertesave te banimit, qendrave arsimore dhe institucioneve.


Per vitet 2018 – 2020 eshte parashikuar qe te ardhurat te arrijne shifrat si me poshte:

	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Tarifa per dhenie licence per tregtim	2,000	2,200	2,800

Te Ardhurat e tjera

TË ARDHURA TË TJERA	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
<i>Të ardhura nga kundravajtjet ad ministrative (Gjobat)</i>	1,800	2,000	2,100
<i>Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të Bashkisë</i>	21,000	23,500	25,000
<i>Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime</i>	100	120	150
<i>Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve</i>	150	170	200
<i>Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara</i>	100	150	200
<i>Të ardhura nga privatizimi</i>	50	65	70
<i>Të ardhura te tjera</i>	500	600	600
<i>Të ardhura nga sponsorizimet</i>	7,000	8,000	10,000
TOTALI	30,700	34,605	38,320





Ne te ardhurat e tjera peshen me te madhe me rreth 68.4 % e zene te ardhurat nga dhenia me qera e aseteve dhe me rreth 22.8 % te ardhurat nga sponsorizimet.

A.2 Parashikimi bazuar në politikat fiskale

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar tek të dhënat aktuale, si dhe duke ju referuar me tendencë rritjeje kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite, ku synohet shtrirja dhe zgjerimi i bazës së taksapaguesve kryesisht në zonat rurale, falë krijimit të databas-it të mirëfillta në çdo njësi, politikave fiskale lehtësuese, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të taksapaguesit, rritjes së efiçensës së agjentit tatimor, krijimit të lehtësive për pagesë, rritjes së mëtejshme të kapacitetit profesional të administratës vendore, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin etj


Rëndësi e veçantë i jepet edhe rritjes së transparencës, përmirësimit të klimës, dhe trajtimit të biznesit si partner bashkisë në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Ndryshimet ligjore të fund-vitit 2015 në sistemin fiskal, nga njëra anë, synojnë të lehtësojnë biznesin dhe, nga ana tjetër, rregullojnë dhe normalizojnë situatën në shumë sektorë të ekonomisë lokale. Këto ndryshime, njëkohësisht, rrisin të ardhurat e Bashkisë Vau Dejës, duke bërë të mundur ofrimin e më shumë shërbimeve me një cilësi më të lartë.

1. **Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël** është shfuqizuar, duke lehtësuar kështu biznesin e vogël dhe sidomos të vetëpunësuarit. Kështu, biznesi me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë do të paguajë **zero** taksa. Ndërsa biznesi me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë lek do të paguajë 5% të fitimit të tatueshëm.
2. **Taksa mbi pasuritë e paluajtshme**, për shtëpitë e banimit, mbetet në të njëjtin nivel si më parë, me përjashtimin e vetëm se do të aplikohet ulja me 50% për njësitë administrative Bushat, Hajmel, Temal, Shllak dhe Vig- Mnele. Përsa u përket ndërtesave për tregti, kjo taksë ndryshon për biznesin e vogël dhe për biznesin e madh me -10%, nga 200 lek/m² në 180 lek/m². Në 5 Njesite e sipërpërmendura kjo taksë është sërish 50% më e ulët se në Njesine Administrative Vau Dejës.
2. Me propozimin e Ministrisë së Financës, është vendosur **një taksë mbi truallin**, e cila është në nivele simbolike, ku individët do të paguajnë vetëm 0,14 lek/m² në vit ndërsa bizneset vetëm 12 lekë/m² në vit.
3. **Taksa e fjetjes në hotel** deri më sot është llogaritur si 5% e çmimit për çdo natë të shpenzuar në hotel. Me ndryshimet ligjore, taksa e fjetjes për hotelet me 4-5 yje do të jetë vetëm **105 lekë** për çdo natë, ndërsa për bujtinat, motelet etj do të jetë vetëm 35 lekë për çdo natë.
5. **Taksa e ndikimit në infrastrukturë** ka ndryshuar dhe nuk do të llogaritet më në kufijtë 1% deri në 3% të vlerës së investimit, por në kufijtë në 4-8% të çmimit të shitjes.
6. **Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme** mbetet në nivelin ekzistues: 100 Lek/m² për ndërtesat e banimit, nga 300 Lek/m² për ndërtesat për tregti dhe shërbime dhe 200 Lek/m² për ndërtesat e tjera. Ndërkohë, për njësitë administrative Bushat, Hajmel, Temal, shllak dhe Vig - Mnele do të aplikohet niveli sipas ligjit, pra pekatesisht 100 Lek/m² për ndërtesat e banimit, 300 Lek/m² për ndërtesat për tregti dhe shërbime dhe 200 Lek/m² për ndërtesat e tjera
7. **Taksa e tabelës** për tabelat identifikuese deri në 2 m² kjo taksë do të jetë zero, pra do të shfuqizohet. Cilido që ka një biznes dhe dëshiron ta identifikojë atë nuk do duhet t'i paguajë Bashkisë as edhe një qindarkë. Për tabelat mbi 2 m², pra për tabelat reklamuese kjo taksë nuk do të ndryshojë, por do të mbetet në nivelin e mëparshëm prej 45.000 Lek/në vit.

A.3 Trendi i rritjes së të ardhurave


Për periudhën 2018-2020 të ardhurat në total nga tarifat vendore parashikohet të kenë 5.6 % ne vitin 2018 kundrejt vitit 2019 dhe me rreth 6.7% rritje ne vitin 2020 kundrejt vitit 2019 dhe kjo bazuar kryesisht tek rritja e numit të bizneseve, shtrirja e mëtjshme e bazës takspaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrdhënies me takspaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.



Plani i të ardhurave bazohet tek harmonizimi dhe trajtimi sa më drejtë me taksa dhe tarifa për gjithë gamën e larmishme të bizneseve e familjeve, me aktivitete dhe vendodhje në zona me funksione të ndryshme. Ai mundëson dhe siguron pëmbushjen e funksioneve të shumta të bashkisë ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar njëkohësisht objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë zonës.

III.2.1 Transferta e Pakushtezuar

Njesite Vendore	<u>ne leke</u>										
	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Bushat	40,309,410	40,550,567	41,523,780	40,827,223	52,093,400	26,598,000					
Hajmel	12,562,130	12,185,268	12,671,917	13,447,018	13,581,488	6,180,000					
Shllak	10,439,780	10,248,104	10,494,059	10,130,249	10,940,669	5,115,000					
Temal	10,735,860	10,538,752	10,791,682	11,693,651	12,629,143	5,904,000					
Vau i Dejes	36,489,180	35,819,242	36,678,904	39,356,862	41,556,914	75,704,300	197,492,000	202,644,902	206,698,000	217,859,000	240,300,000
Vig-Mnela	11,656,440	11,306,750	11,476,351	10,301,572	11,125,698	5,201,000					
TOTAL	122,192,800	120,648,683	123,636,693	125,756,574	141,927,311	124,702,300	197,492,000	202,644,902	206,698,000	217,859,000	240,300,000



Sikurse shihet në grafik, pas reformës territoriale, transferta e pakushtëzuar për Bashkinë Vau Dejes (përfshirë të gjitha NJA-të) është më e vogël se në të gjithë periudhën 2008-2015. Nderkohe që në vitin 2018 sipas udhezimit është rritur vetëm 2% , për 2019 është rritur 5.4% dhe planifikohet një rritje më e dukshme në vitin 2020 me 10.3 % rritje .

III.2.2 Transferta specifike sipas funksioneve.

Transferimi i funksioneve të reja

Me miratimin e Ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”, Bashkia Vau Dejes u përball me kërkesën për marrjen e përgjegjësisë për transferimin dhe menaxhimin në vijim të funksioneve të reja të përcaktuara me ligj.

Funksionet e reja specifike që u transferuan në Bashki ishin:

Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Ne vitin 2016 dhe vitin 2017 , Bashkisë Vau Dejes i është transferuar funksioni i administrimit të fondit për arsimin parauniversitar.

Në transfertën specifike, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar.

Në këtë transfertë për Bashkinë Vau Dejes janë përfshirë: fondet për paga dhe sigurime shoqërore (jo në vlerën e plotë të kërkuar për t’u transferuar) të personelit (punonjës dhe edukator) dhe shpenzimet operative për konviktet.

Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe të VKM nr. 175 date 8.3.2017 “ *Per trajtimin me page dhe shtesa mbi page te punonjesve mesimore ne arsimin parauniversitar* “ që filluan efektet financiare me 1 Mars 2017 si dhe VKM nr. 351, datë 19.4.2017 “*Për një shtesë në vendimin nr.175 , datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me page dhe shtesa mbi page të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar* .

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në fillimit të vitit 2016, ka dërguar kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me: dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor, personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Bashkia Vau Dejes ka realizuar procesin e transferimit të dokumentacionit të personelit, dhe pagesës së pagave dhe sigurimeve shoqërore të vitit 2016.

Me shkresën nr 343, date 15.01.2016 të Ministrisë së arsimit drejtuar Bashkisë Vau Dejes dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale, në zbatim të VKM-se nr 1102, date 28.12.2015 jemi njoftuar për kalimin e kompetencës në pagesën e transportit të punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxenesve që mesojnë jashtë vendbanimit. Në këtë shkresë cilësohet që Drejtoria Arsimore duhet të na vinte në dispozicion çdo muaj numrin e punonjësve dhe nxenesve që përfitojnë nga ky shërbim. Është realizuar procesi i pagesave të transportit të

punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit për vitin 2016.

Në transfertën specifike të vitit 2018-2020, janë planifikuar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar.

Ne udhezimin plotësues 10/1 date 28.2.2017 “ Per buxhetin vendor” shpenzimet duhej të planifikoheshin në vitin 2018 me 4.2% rritje , në vitin 2019 të njëjta me 2018 dhe në vitin 2020 me 7.1% rritje.

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit

Në transfertën specifike të vitit 2016 dhe në vitin 2017 , janë akorduar fondet për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi.

Në këto fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Në zbatim të shkresës së Ministrisë së Punëve të Brendshme nr.04 Prot.. date 05.01.2016 “Per kalimin e dokumentacionit të pagesës së personelit dhe të inventarit të aktiveve të shërbimit Zjarrfikës pranë Njësisë të Qeverisjes Vendore” Bashkia Vau Dejës ngriti grupin e punës me Urdhërin e Brendshëm të Kryetarit nr. 4 datë 12.01.2016 për marrjen në dorëzim të dosjeve të personelit, të aseteve dhe inventarëve ekonomik.

Bashkia Vau Dejës ka realizuar procesin e transferimit të dokumentacionit të personelit, dhe pagesës së pagave dhe sigurimeve shoqërore të muajve Dhjetor 2015 e në vazhdim, në kohë dhe pa krijuar asnjë problem.

Prefektura Shkoder ka dërguar pranë Bashkisë Vau Dejës shkresën nr.221 date 08.03.2016 mbi “Kalimin e dokumentacionit të inventareve të Aktiveve të Qendrueshme e Qarkulluese në Administrim të Shërbimit Zjarrfikës”.

Në transfertën specifike të vitit 2018-2020, janë planifikuar fondet për Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Pagat llogariten në bazë të VKM nr. 350 date 19.4.2017 “ Per trajtimin me pagë dhe shtesa mbi paga të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit “ që fillon efektet me 1 Mars 2017.

Ne udhezimin plotësues 10/1 date 28.2.2017 “ Per buxhetin vendor” shpenzimet duhej të planifikoheshin në vitin 2018 me 4.2% rritje , në vitin 2019 të njëjta me 2018 dhe në vitin 2020 me 7.1% rritje.

Administrimi i pyjeve

Në transfertën specifike të vitit 2016 dhe në vitin 2017, janë akorduar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shumë pak shpenzime operative.

Ministria e Mjedisit transferoi kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me: dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin. Pagat e personelit janë ndryshuar me 1 Mars 2017 dhe konkretisht VKM nr, 202 date 15.3.2017 “ Per disa shtesa në vendimin nr. 717 date 23.6.2009 të Keshillit të Ministrave , “ Per pagat e punonjesve mbështetes të institucioneve buxhetore dhe të nepunesve të disa institucioneve buxhetore “ të ndryshuar “ dhe VKM nr. 187 date 8.3.2017 “ Per miratimin e struktures dhe të niveleve të pagave të nepunesve civile /nepunensve “ që filluan efektet me 1 Mars 2017.

Bashkia Vau Dejës në strukturën organizative të saj, ka krijuar Drejtorinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Bashkia Vau Dejës ka realizuar procesin e transferimit të dokumentacionit të personelit, dhe pagesës së pagave dhe sigurimeve shoqërore të vitit 2016 në kohë dhe pa krijuar asnjë problem.

Në transfertën specifike të vitit 2018-2020, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative gjithashtu është planifikuar dhe shtesa personeli për të realizuar shërbimin.

Në udhezimin plotësues 10/1 date 28.2.2017 “ Per buxhetin vendor” shpenzimet duhej të planifikoheshin në vitin 2018 me 4.2% rritje, në vitin 2019 të njëjtte me 2018 dhe në vitin 2020 me 7.1% rritje.

Rrugët Rurale

Në transfertën specifike të vitit 2016 dhe vitit 2017, janë transferuar fondet minimale për rrugët rurale.

Këshilli i Qarkut Shkoder gjatë vitit 2016, ka dërguar pranë Bashkisë Vau Dejës mjetet dhe asetet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 11.11.2015.

Bashkia Vau Dejës, në zbatim të VKM nr 914, datë 11.11.2015 “Per transferimin në pronësi nga keshillat e qarqeve.....”, dhe Udhezuesit të AZRT nr 500/72, datë 07.12.2015, ka ngritur grupin e punës për marrjen në dorezim të rrugëve rurale me Urdherin e brendshëm të Kryetar-es së Bashkisë nr 326, datë 30.12.2015, proces i cili tashmë ka përfunduar.

Në transfertën specifike të vitit 2018-2020, janë planifikuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki bazuar në udhezimin plotësues 10/1 date 28.2.2017 “ Per buxhetin vendor” shpenzimet duhej të planifikoheshin në vitin 2018 me 4.2% rritje, në vitin 2019 të njëjtte me 2018 dhe në vitin 2020 me 7.1% rritje .

Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën specifike të vitit 2016 dhe vitit 2017 , janë transferuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Bashkia Vau Dejes , në zbatim të VKM nr 1108, date 30.12.2015 dhe Udhezuesit të AZRT nr 540/1, date 31.12.2015, ka ngritur grupin e punës për marrjen në dorezim të funksionit të ujitjes dhe kullimit me Urdherin e brendshëm të Kryetar-es së Bashkisë nr 3, date 12.01.2016 dhe ka kryer procesin e marrjes në dorezim i aseteve.

Në transfertën specifike të vitit 2017, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Llogaritja e pagave është bërë në bazë të VKM nr, 202 date 15.3.2017 “ Për disa shtesa në vendimin nr. 717 date 23.6.2009 të Keshillit të Ministrave , “ Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nepunësve të disa institucioneve buxhetore “ të ndryshuar “ ,VKM nr. 187 date 8.3.2017 “ Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nepunësve civilë /nepunësve “ që filluan efektet me 1 Mars 2017.

Në udhëzimin plotësues 10/1 date 28.2.2017 “ Për buxhetin vendor” shpenzimet duhej të planifikoheshin në vitin 2018 me 4.2% rritje , në vitin 2019 të njëjta me 2018 dhe në vitin 2020 me 7.1% rritje.

III.2.3 Transferta e kushtëzuar.

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë, për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Nga transferta e kushtëzuar financohen transporti arsimtarë dhe i nxënësve në arsimin parashkollor, 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm..

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Njësitë e qeverisjes vendore, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve. Ky fond përfitohet për financimin e projekteve për të cilat aplikojnë njësitë e qeverisjes vendore, në fushat e infrastrukturës rrugore vendore, arsimin, shëndetësisë, kulturës, etj.

Aplikimi për fonde bëhet pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit për objektet e infrastrukturës rrugore dhe shërbimeve publike si dhe për fushat e tjera si arsimi, kultura etj.

Projektet miratohen nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, mbi bazën e politikave dhe programeve të zhvillimit të rajoneve të Shqipërisë i cili përcakton edhe masën e kontributit/bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore. Komiteti duhet të marrë vendime bazuar në raportet e sekretariateve teknike të Ministrive të Linjës, të cilat bëjnë vlerësimin tekniko-ekonomik dhe listimin e projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore, bazuar në VKM nr.135, datë 03.02.2010 për “Përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”.

Bashkia Vau Dejes paraqet listën e projekteve të investimeve kapitale prioritare për aplikim në thirrjet e herëpasheshme që publikohen nga Fondi i zhvillimit të rajoneve.

Duke filluar nga ky vit, ky fond do të jete transferte e kushtezuar dhe nuk do të jete i trashëgueshem për njesite e vetqeverisjes vendore.

V. Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2018-2020

Gjatë vitit 2018-2020, përmes këtyre shpenzimeve të planifikuara, Bashkia e Vau Dejes synon të punojë duke iu përgjigjur objektivave sipas programeve lokale të zhvillimit si dhedetyrimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj:

- Administrata vendore
- Emergjencat civile
- Planifikimi, administrimi dhe kontrolli i territorit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;
- Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane;
- Parqet, lulishtet dhe hapësirat e hapura publike;
- Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm
- Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura;
- Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara;
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit;
- Shërbimi i dekorit publik;
- Ndriçimi i mjediseve publike

- Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal;
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë;
- Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike;
- Publikim i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik etj.
- Zhvillimi i Turizmit
- Administrimi i infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- Administrimi i sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore.
- Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural, përfshirë statistikat bujqësore vendore, sipas legjislationit në fuqi.
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.
- Sistemi arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.
- Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimin dhe rehabilitimi i qendrave shëndetësore.
- Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreacionale,.

Tabela 7 Plani i shpenzimeve per vitin 2018 sipas programeve

P/Plani Viti 2018

Programe	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali	000/leke			
						Tr.Pakusht ez.	Ardhura	Tr.Specifike	Tr.Kushtezu ar
Planifikim Manaxhim Administrim	134,362	24,936	-	1,000	160,298	118,465	36,415	-	5,418
Planifikimi urban	-	-	-	39,850	39,850	-	19,850	-	20,000
Infrastruktura rrugore	-	5,782	-	815,300	821,082	56,476	9,800	5,782	749,024
Programi i Sherbimeve Publike Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.	34,589	21,840	-	-	56,429	27,908	28,521	-	-
Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	2,825	33,633	-	55,000	91,458	-	2,411	3,047	86,000
Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	-	-	-	100,100	100,100	-	100	-	100,000
Bujqesia dhe zhvillimi rural	7,641	18,306	-	32,000	57,947	-	14,865	11,082	32,000
Emergjencat civile	10,066	1,042	-	-	11,108	-	-	11,108	-
Arsimi dhe kultura	61,155	25,915	-	261,300	348,370	-	38,632	43,938	265,800
Shërbimet sociale	4,503	124	280,600	70,200	355,427	2,252	2,375	-	350,800
Fond rezerve	-	-	3,193	-	3,193	1,597	1,596	-	-
TOTALI	255,141	131,578	283,793	1,374,750	2045262	206,698	154,565	74,957	1,609,042

Tabela 8 Realizimi i shpenzimeve per vitin 2019 sipas programeve

P/Plani Viti 2019

Programe	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali	000/leke			
						Tr.Pakushte z.	Ardhura	Tr.Specifike	Tr.Kushtezu ar
Planifikim Manaxhim Administrim	128,794	36,403	-	2,000	167,197	105,463	56,045	-	5,690
Planifikimi urban	-	-	-	24,400	24,400	-	14,400	-	10,000
Infrastruktura rrugore	-	5,782	-	775,307	781,089	76,152	-	5,782	699,155
Programi i Sherbimeve Publike Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.	35,281	29,420	-	-	64,701	32,351	32,350	-	-
Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	2,825	28,633	-	36,000	67,458	-	2,411	3,047	62,000
Bujqesia dhe zhvillimi rural	-	-	-	100,050	100,050	-	50	-	100,000
Bujqesia dhe zhvillimi rural	7,962	18,306	-	18,000	44,268	-	15,186	11,082	18,000
Emergjencat civile	10,066	1,042	-	-	11,108	-	-	11,108	-
Arsimi dhe kultura	61,499	27,144	-	197,850	286,493	-	38,705	43,938	203,850
Shërbimet sociale	4,593	135	292,000	210,502	507,230	2,297	2,431	-	502,502
Fond rezerve	-	-	3,194	-	3,194	1,597	1,597	-	-
TOTALI	251,020	146,865	295,194	1,364,109	2,057,188	217,860	163,175	74,957	1,601,197

Tabela 9Realizimi i shpenzimeve per vitin 2020 sipas programeve

P/Plani Viti 2020

Programe	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali	000/leke			
						Tr.Pakusht ez.	Ardhura	Tr.Specifike	Tr.Kushtez uar
Planifikim Manaxhim Administrim	137,816	37,176	-	9,385	184,377	115,583	62,707	-	6,088
Planifikimi urban	-	-	-	18,150	18,150	-	8,150	-	10,000
Infrastruktura rrugore	-	6,193	-	391,800	397,993	86,273	6,500	6,193	299,027
Programi i Sherbimeve Publike Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.	35,987	33,020	-	-	69,007	34,504	34,503	-	-
Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	3,026	19,133	-	60,000	82,159	-	2,896	3,263	76,000
	-	-	-	79,250	79,250	-	50	-	79,200
Bujqesia dhe zhvillimi rural	8,302	18,306	-	20,000	46,608	-	14,740	11,868	20,000
Emergjencat civile	10,780	1,116	-	-	11,896	-	-	11,896	-
Arsimi dhe kultura	64,970	29,084	-	549,350	643,404	-	40,496	47,058	555,850
Shërbimet sociale	4,685	135	292,000	207,802	504,622	2,343	2,477	-	499,802
Fond rezerve	-	-	3,194	-	3,194	1,597	1,597	-	-
TOTALI	265,566	144,163	295,194	1,335,737	2,040,660	240,300	174,116	80,278	1,545,967

Aneks 1: Baza ligjore

- Ligj nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 68/20417 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore”
- Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimi të buxhetit"
- udhezimin nr. 23 date 22.11.2016 “ *Per procedurat standarte te pergatitjes se programit Buxhetor Afatmesem*”, si dhe .
- Udhëzimi Plotesues 10/1 date 28.2.2017 “ “ Per pergatitjen e buxhetit vendor”
- Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- Ligj nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- Shkresës së Ministrisë së Punëve të Brendshme nr.04, datë 05.01.2016 “Për kalimin e dokumentacionit të pagesës së personelit dhe të inventarit të aktiveve të Shërbimit Zjarrfikës pranë njësive të qeverisjes vendore”;
- VKM nr. 1108,datë30.12.2015 “Për transferimin, nga ministria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe administrimit të ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”
- Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108, datë 30.11.2015 "Për transferimin, nga ministria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe administrimit të ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”.